



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.44/2018  
Prishtinë, më 16.10.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari- Lila, Muharrem Nitaj, Memli Krasniqi, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Glauk Konjufca, dhe Liburn Aliu, anëtarë.

**Pjesëmarrës tjerë:** Blenda Bejtullahu - EU office; Lirdon Gashi, SEEF; Diellza Luzha, KDI; Shefki Kastrati, NDI dhe përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 9.10.2018;
- 3.Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për kandidatët për kryesues të Bordit të ZRRE-së;
- 4.Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-079 për eficiencë të energjisë;
- 5.Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete;
- 6.Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Muharrem Nitaj**, kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës, pika e tretë: “*Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për kryesues të Bordit të ZRRE-së*”, meqenëse komisioni ka kërkuar nga Zyra e Kryeministrit, sqarim dhe akoma nuk kemi marrë përgjigje. Po ashtu, njoftoi se ka biseduar me përfaqësuesit e ZKM-së, ku është njoftuar, se shumë shpejt do ta dërgojnë listën e korrigjuar të këtij gabimi që ka ndodhur, ku do të përfshihen gjithsej 4 kandidatët, që i kanë plotësuar kushtet.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga deputeti Nitaj.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 9.10.2018**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 9.10.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë**

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e komisionit, se komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë koment apo vërejtje për Projektligjin për efikasitet të energjisë, përveç Komisionit për Buxhet, i cili nuk e ka shqyrtuar raportin në afatin e paraparë me Rregullore. Andaj, sipas procedurës, raporti me rekomandime procedohet në lexim të dytë, në Kuvend.

*Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

### *Përfundim*

*1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë.*

*2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

**Kryetarja**, tha se për shkak se është i një rëndësie të veçantë, ky projektligj, duke marrë parasysh obligimet ligjore dhe vonesat që ka Kosova në fushën e efikasitetit të energjisë, në kuadër të Komunitetit të Energjisë, bazuar në Rregulloren re të Kuvendit, propozoi që ky projektligj të përfshihet në rendin e ditës të mbledhjes plenare të Kuvendit, të datës 18 tetor 2018, për shqyrtim në lexim të dytë.

*Komisioni, njëzëri, e miratoi propozimin e kryetares.*

## **4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete**

**Kryetarja**, po ashtu, i njoftoi anëtarët e komisionit, se komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë koment apo vërejtje për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, përveç Komisionit për Buxhet, i cili nuk e ka shqyrtuar raportin në afatin e paraparë me Rregullore. Andaj, sipas procedurës, raporti me rekomandime duhet të shkojë në lexim të dytë, në Kuvend.

**Mimoza Kusari - Lila**, tha se duke marrë parasysh kundërshtimet që ky projektligj i sjell për mjedisin dhe rreziqet që i sjell, ne nuk qëndrojmë në takim për të kaluar ky projektligj. Ne, si opozitë, do ta lëshojmë mbledhjen.

*Së bashku me deputeten, znj. Mimoza Kusari – Lila, mbledhjen e lëshuan edhe z. Dardan Sejdiu dhe znj. Hykmete Bajrami.*

**Memli Krasniqi**, tha se është më shumë se qesharake, e dobët, teatrale, që s'ka të bëjë me interesat e opinionit publik. Le të tregojnë çka kanë bërë për ambientin? Po flasim për dy ish-ministra. Çka kanë bërë për të ulur ndotjen? Kjo çka bënë sot, është më shumë se hajgare, është turp. Obligimi i tyre është të votojnë kundër. Ideja që këta dalin sot, kishe po e mbrojnë ambientin, kjo është gënjeshtër.

**Muharrem Nitaj**, tha se është hipokrizi veprimi i deputetëve, që lëshuan mbledhjen e komisionit. Po ashtu, znj. Kusari rrallë ka ardhur, se nuk mbaj mend a ka ardhur ndonjëherë në grupin punues, edhe pse ka qenë pjesë e grupit. Opozita ka qenë e përfshirë në këtë projektligj, në grupin punues. Logjika që të votohet ligji në komision e pastaj të bojkotohet seanca, mendoj që është më së paku hipokrizi.

**Veton Berisha**, tha se duhej që opozita të ishte këtu dhe të kalojë, e në seancë të jepte fjalën përfundimtare, se nuk pajtohen me këtë çështje.

**Kryetarja**, tha se ajo çfarë bënë deputetët opozitarë nuk është opozitë kundër mazhorancës, por brenda partive të tyre. Edhe përkundër këtyre veprimeve, ne do ta vazhdojmë punën dhe qytetarët le të vendosin mandej se kush ka punuar mirë e kush jo.

*Pas debatit, komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

*1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete.*

*2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

## **5. Të ndryshme**

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e komisionit, se lidhur me Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, datë 5.10.2018, rastin nr.376/2018; Kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/132 për automjete. Andaj, ne duhet që brenda afatit prej 30 ditëve, të kthejmë përgjigje.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

**Sala BERISHA SHALA**